



Agro & Social Fund
sh.p.k



2020

VEŠTNI RAPORT


www.asf.al

Përmbajtja


Historiku Institucional	3
Misioni, & Vlerat Thelbësore	5
Mesazhi nga Drejtori Ekzekutiv	6
Sfidat dhe Arritjet 2020	7
Bilanci	17
Pasqyra e të Ardhurave	18
Pasqyra e Flukseve të Parasë	19
Raporti i Auditorëve të Pavarur	21
Performanca Sociale	23
Projekte	25
Klientët Tanë	26
Partnerët	27



Historiku institucional



Rrjeti i degëve të Agro & Social Fund:



**Dega Rajonale
Lezhë**
që prej vitit
2001



**Dega Rajonale
Korçë**
që prej vitit
2003



**Nën Dega
Laç**
që prej vitit
2007



**Nën Dega
Librazhd**
që prej vitit
2008




**Dega Rajonale
Elbasan**
që prej vitit
2011



**Dega Rajonale
Tiranë**
që prej vitit
2018



**Nën Dega
Pogradec**
që prej vitit
2018



**Nën Dega
Bilisht**
që prej vitit
2018



**Dega Rajonale
Lushnje**
që prej vitit
2020



**Nën Dega
Tiranë**
që prej vitit
2020

Misioni i Agro & Social Fund

Ne mbështesim zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirjen financiare dhe kohezionin social, nëpërmjet asistencës së përgjegjshme financiare të ndërmarrjeve micro e të vogla kryesisht, me

qëllim zvogëlimin e varfërisë, lehtësimin dhe përmirësimin e jetës në komunitete dhe zgjerimin e oportuniteteve për punësim, duke operuar kryesisht në zonat rurale e semi-urbane, por dhe ato urbane.

Vlerat e Agro & Social Fund

Agro & Social Fund është i fokusuar në përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve që i ofrohen klientelës së synuar, kryesisht nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm të kërkesave të tyre, krijimit të mundësive për klientët, familjet dhe komunitetet në rritjen e mirqenies, uljen e varfërisë apo vulnerabilitetit, rritjes së aksesit në finance, krijimit të vendeve të reja të punës apo dhe shtimit të vlerës së atyre ekzistuese.


Në rrugëtimin tonë të udhëhequr nga misioni, ne ruajmë e pasurojmë vlerat tona.

Ne përpiqemi t'i shfrytëzojmë këto vlera me qëllimin që të sigurojmë punonjës të motivuar dhe të orientuar drejt rritjes së rezultateve dhe mbrojtjen nga devijimi i misionit, punonjës që do arrijnë të zhvillohen e veprojnë në sintoni të plotë me linjën për rritjen e objektivave të institucionit.

Jemi të **përkushtuar** për të punuar pranë njerëzve, me qëllim nxitjen e përmirësimit të jetës së tyre.

Vlerësojmë njerëzit, i konsiderojmë të barabartë dhe u japim **përparësi** përkundrejt fitimit e qëllimeve tradicionale të biznesit.

Ne vlerësojmë e promovojmë **transparencën** dhe sjelljen etike



Mesazhi i Drejtorit Ekzekutiv



Të nderuar,

Viti 2020 që lamë pas, do të mbetet si një vit reference për gjithë njerëzimin për privacionet, dhimbjen, vuajtjet dhe sakrificat, si rrjedhoja të pashmangshme të një pandemie të frikshme, por edhe për potencialin njerëzor, angazhimin për të tejkaluar të keqen dhe solidaritetin për të ndihmuar këdo në vështirësi dhe në nevojë, si një shpresë se vlerat njerëzore prevalojnë mbi çdo rrethanë dhe se e ardhmja jonë mund të ndërtohet e sigurtë dhe më e shëndetëshme.

Së bashku me çdo klient, bashkëpunëtor, financues dhe donatorë, me shumë empati, vetëpërbajtje dhe durim, përkushtim dhe punë, arritëm të ndërtojmë një bashkëveprim të dobishëm, që krijoi besim për të na ofruar mjetet e nevojshme financiare për të punuar; që mundësoi mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe punësimin e qindra individëve; që gjeneroi një proces rritjeje profesionale për të gjitha nivelet e stafit nën asistencën ndërkombëtare të fituar dhe kualifikim sipas standardeve ndërkombëtare, duke përfutur një vlerësim financiar ndërkombëtar të kënaqshëm pas “skanerit” të Microfinanza Rating .

Të gjithë sa më sipër vendosën një standard të ri dhe shënuan progresin e synuar për Institucionin, si dhe mundësuan një ecje të sigurtë për çdo anëtar të familjes sonë.

Gjatë vitit 2020, portofoli i kredisë shënoi një rritje prej 19.3% krahasuar me një vit më parë duke arritur në rreth 770 milion lekë dhe ju shërbye rreth 1800 klientëve, të cilët disbursuan rreth 564 million lekë.

Ne jemi krenarë që gjatë vitit 2020 ne lehtësuam përmirësimin e cilësisë së jetës në mënyrë indirekte të 4,057 fëmijëve, ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetës të 230 klientëve nga grupet e marginalizuara dhe ju krijuam mundësinë rreth 205 klientëve të tjerë të ishin sipërmarrës të një biznesi për herë të parë, siguroam që rreth 43% e totalit të klientëve të jenë të përqëndruar në zonat rurale dhe rreth 45 % e numrit të klientëve të ishin klientë “femra”.

Për gjithë arritjet, sfidat e përballura, dëshiroj të falenderoj çdo klient, të falenderoj çdo donator dhe huadhënës, dhe mbi të gjitha të falenderoj stafin e përkushtuar të Agro & Social Fund.

Duke menduar dhe vepruar për të ardhmen, i uroj gjithësecilit prej aktorëve të kësaj marrëdhënie rrugëtim të mbarë, mirëqenie dhe prosperitet.

Ne do të vazhdojmë të jemi të angazhuar për zhvillimin lokal dhe të qëndrueshëm, nxitjen e sipërmarrjes, uljen e varfërisë, punësimin, dhe në veçanti punësimin e të rinjve, grave dhe shtresave të marginalizuara.

Faleminderit!



Rozana OROZI
Drejtor Ekzekutiv

Sfidat & Arritjet 2020



Agro & Social Fund në mbyllje të dekadës së dytë të aktivitetit të tij dhe si një subjekt që prej më shumë se tre vite nën administrimin e Aksionarit të ri, Fondi Besa sh.a, po ecën me një mision të qartë dhe objektiva ambiciozë.

Ky mision është i orientuar drejt zhvillimit dhe rritjes së sipërmarrjes, forcimit të karakterit social të nismave dhe duke adresuar çështje që kanë në fokus zonat rurale e gjysëm urbane kryesisht, pa neglizhuar edhe zonat urbane.



Ngjarja e tërmetit në fundit të vitit 2019 si dhe pandemia, e cila mbizotëroi gjatë gjithë vitit 2020, na vendosën përpara domosdoshmërinë për menaxhimin optimal të fondeve që kishim në dispozicion duke mbajtur në kontroll shpenzimet e duke i përdorur fondet në mënyrën më produktive, si dhe përpjekjet për të shfrytëzuar të gjitha hapësirat për sigurimin e fondeve të reja. Ja kemi dalë, duke respektuar me rigorozitet të gjitha detyrimet me palët e treta dhe likuidimit të tyre pa asnjë vonesë, si dhe kemi arritur të finalizojmë disa angazhime të rëndësishme me partnerët tanë për fonde të reja.



Arritëm të siguronim një rezultat financiar pozitiv, gati po aq sa viti paraardhës megjithë efektet negative të pandemisë COVID-19



Arritëm të përgatisim dhe të tregtonim në treg, në kushte jo të zakonshme, dy produkte të reja, të cilat siguruan rreth 17% të portofolit të disbursuar (në numër kredish) dhe 12% të portofolit të disbursuar (në vlerë kredish), duke e çuar në 8 produkte, inventarin e produkteve në shërbim të klientelës

Pandemia dhe vendimarrja që lidhej me situatën u reflektua në sistemin e kredive live, duke krijuar lehtësira në skedulet e pagesave, me skenare të ndryshëm sipas kërkesave nga klientet e ASF.



Arritëm të ndërtonim me burimet të brendshme faqen e re web të institucionit (pothuaj pa kosto), e cila ka përmirësuar ndjeshëm mënyrën e organizimit dhe prezantimit të informacionit, ka rritur sasinë, cilësinë dhe spektrin e tij, ka impaktuar pozitivisht forcimin e imazhit mbi qëndrueshmërinë dhe përgjegjësinë sociale të ASF-së, ka forcuar elementë të

Brandit, ka krijuar lehtësinë për të sjellë lajme dhe informacione në faqe në kohë reale dhe ka mundësuar përdorimin e faqes mobile-friendly.



Zoom/Skype conference call u bënë mjete pune më familjare për stafin në tërësi, duke siguruar në këtë mënyrë komunikim të vazhdueshëm, për të qënë bashkë në përballimin e kësaj situate. 2020-ta ishte një vit intensiv për ASF në ofrimin e trajnimeve për stafin e saj, me një shumatore prej 44 trajnimësh të marra nga stafi gjatë vitit.



ASF përfaqësojmë një ekip prej **67** profesionistësh e personeli ndihmës, që i shërben më shumë se **2,749** klientëve

ASF, ndër vite, paraqitet me një rritje portofoli prej 29% (2017), 59% (2018), 28% (2019) dhe 19.3% (2020) ose me një rritje prej 207% të portofolit aktiv krahasuar me fundin e vitit 2016.

Retention RATE 2020 (Raporti i Ruajtjes së klientelës) **77.9%**.



Rreth **43%** e totalit të klientëve vijnë nga zona rurale dhe **45%** janë kliente femra.



Nga vlerësimet, rezulton se rreth **4,057** fëmijë janë impaktuar në mënyrë direkte e indirekte nga kreditë e disbursuara përgjatë vitit 2020.

E organizuar aktualisht në **5** Degë dhe **5** Nën- Degë, që operojnë të shpërndara në të gjithë territorin, arrihet të mbulohet me shërbime një pjesë e veriut, e juglindjes dhe e Shqipërisë qendrore. Me projekte të dedikuara po punohet në zona të veçanta siç është Tropoja dhe Elbasani

Administruam një portofol prej rreth **770 mln lekë**. Në shifra kumulative përgjatë këtyre viteve ju është shërbyer rreth 26,244 klientëve, duke disbursuar rreth 4,7 mld Lekë



Arritëm të finalizonim një marrëveshje tregtare për fonde me një nga bankat e nivelit të dytë, e para kjo që prej vitit 2013, realizuar për herë të fundit nga ish-Vision Fund Albania; janë realizuar gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi për fonde me KIVA-n, Dorcas International apo Diaconia, të cilat (në përmbushje edhe të misionit social) janë shoqëruar me fee të vogla ose thjesht me detyrim për kthim fondesh pa interes.

Certifikimi nga MFR



Agro & Social Fund përgjatë vitit 2020 arriti të përmbyllë një proces vlerësimi ndërkombëtar “Financial Rating” nga MICROFINANCA RATING (vlerësues ndërkombëtar i njohur nga Komisioni Evropian), me vlerësimin “BB-Stable”, duke siguruar një certifikatë konfirmuese për përmirësimin e operacioneve si dhe një instrument vetkontrolli dhe vetëpërsosjeje


Gjithashtu gjatë vitit 2020 Agro & Social Fund avancoi në procesin e Code of Good Conduct, i cili pritet të mbyllet me sukses në Mars 2021, ku përgjatë një procesi që shkon më shumë se një vit, arritëm të përmirësonim e përshtasim një spektër të gjerë dokumentesh mbështetëse të operacioneve të përditëshme në përputhje me kërkesat e Code of Good Conduct, me synimin për rritjen e cilësisë së shërbimeve, transparencës, cilësisë së informacionit, cilësisë së marrdhënieve e besimit përgjatë një zinxhiri të gjerë që përfshin klientët, partnerët, investitorët apo dhe vetë fashat në hierarkinë brenda ASF-së.




Arritjet në kredidhënie

- ✔ Administrimi dhe menaxhimi i Fondeve me përgjegjshmëri, transparencë dhe efektivitet. Në një vit të vështirë të një Pandemie Globale;
- ✔ Rritjen e volumit të kredive Aktive në Numër me **279 klientë** dhe **125 milion** në Vlerë, respektivisht me **11,1%** dhe **19,3%**, per vitin 2020.
- ✔ Rritjen e volumit të Disbursimit ne Numer-**37 kliente** dhe **9 milion** ne Vlere respektivisht me **6,4%** dhe **1,7%**, per vitin 2020.
- ✔ Rritjen e volumit Kumulativ ne Numer me **1813 kliente** dhe me **564 milion** neVlere respektivisht **7,3%** dhe **13,2%**, per vitin 2020.
- ✔ Analizën e kapacitetit pagues të klientëve dhe burimet e te ardhurave;
- ✔ Cilësinë e portofolit edhe pse ne kushtet e nje viti te veshtire;
- ✔ Monitorimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të kredidhënies;
- ✔ Rritja e efikasitetit të stafit kreditues në të gjitha degët e Agro & Social Fund, si dhe integrimi eficient i stafit të ri - nëpërmjet stimulimit të praktikave të bashkëpunimit dhe nxitjes së frymës së grupit (ekipit);
- ✔ Realizimi periodik i trajnimeve te stafeve te Degeve si dhe i Menaxhereve te tyre me trajnues te huaj dhe vendas.
- ✔ Realizimi periodik i analizës së rezultateve për çdo Degë Rajonale, bazuar në realitetet respektive të çdo Dege, stafit të tyre, etj - ruajtja e afërsisë dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me punonjësit në Degë dhe stimulimi i frymës së ekipit, pavarësisht rritjes graduale të organizatës;
- ✔ Rruajtja e afersise dhe komunikimit te drejtperdrejte me punonjesit ne Dege dhe stimulimi I frymes se ekipit, pavaresisht rritjes graduale te Institucionit.


Numri dhe shuma e kredive aktive / Number and amount of active clients



Numri dhe shuma e disbursuar në vit / Number and amount disbursed during the year




Numri dhe shuma kumulative e kredive të shpërndara / Cumulative number and amount of loans




Produktet tona të Kredisë



Shpërndarja e Portofolit sipas Produkteve




Shpërndarja e Portofolit sipas Gjinisë



Procesi i drejtimit të riskut është një proces i vazhdueshëm ku etapat “ndjekin” njëra tjetrën gjatë procesit normal të drejtimit të riskut dhe sa herë që ka ndonjë ndryshim me mjedisin e brëndshëm dhe jashtëm të ASF.

Procesi i menaxhimit të riskut për vitin 2020 ishte seti i veprimeve që u ndërmoren në përpjekje për të alternuar risqet me të cilat institucioni ynë u përball me një format cikli. Pikësynimi themelor i menaxhimit të riskut në ASF është të identifikoj faktorët e riskut dhe efektet e këtyre faktorëve. Risku i ASF-së për 2020 rezulton 3.56%.




Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Viti 2020, ndryshe nga çdo dinamikë, rrjedhe e kaluar në vitet e mëparshme, u shoqërua me sfida të parashikura më parë. I njohur ndryshe si viti i pandemisë, kushtëzoi dhe kufizoi aktivitetin normal të institucionit tonë, diktuar dhe nga direktivat qeverisë, por jo funksionalitetin e Agro & Social Fund. Duke qenë korrekt ndaj çdo kushtëzimi fizik, si dhe reduktimeve të orareve të punës dhe lëvizjeve, konform masave të marra nga shteti shqiptar ASF arriti të përballojë më së miri sfidat e lindura rishtazi, pa afektuar stafin, në reduktim numri apo reduktim të të ardhurave.

Në kohë, dhe duke vlerësuar kapitalin njerëzorë si aset më të çmuar institucional, ASF ngriti menjëherë Grupin e Emergjencës së Pandemisë, për të marrë masa të menjëhershme mbi menaxhimin e situatës duke nisur me:

- ✔ Dezinftimin e të gjitha zyrave të institucionit;
- ✔ Pajisja e tyre me mjetet e nevojshme dezinfektuese personale;
- ✔ Krijimi të hapsirave të reja me qëllim distancimin fizik;
- ✔ Ndërthurjen e punës në zyrë me punën online, si dhe ndalimin kategorik të punës në zyrë për grupet më vulnerabël ndaj këtij virusi (si psh: gratë shtatzënë);
- ✔ Përcjelljen e pandalur për mëse një vit të çdo informacioni drejtuar stafit mbi masat parandaluese që duhet të kishin në vëmendje kundrejt ruajtjes nga infektimi, dhe rregullave që qeveria shqiptare diktonte me qëllim reduktimin maksimal të çdo mundësie kontaminimi të punonjësve me virusin Covid-19.





Përpos situatës pandemike, ASF duke optimizuar menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare, arriti të rekrutojë staf edhe gjatë vitit 2020, duke çuar përpara me hapa të sigurt vizionin dhe planet e ekspansionit të Agro & Social Fund.

2020-ta ishte një vit intensiv për ASF në ofrimin e trajnimeve për stafin e saj. Trajnimet u ofruan si nga stafi manaxherial i ASF-së, ashtu edhe nga *Microfinance Centre* dhe *EaSI*, me një shumatorë prej 44 trajnimesh të marra nga stafi gjatë vitit 2020.


Arritëm të realizonim, për stafin e të gjithë niveleve, një spektër të gjerë trajnimesh, me një totale prej

44 trajnimesh, ku 22 prej të cilave u mundësuan me mbështetjen të *EaSI*-it në formë trajnimesh online dhe nën drejtimin e ekspertëve të huaj dhe vendas, duke rritur cilësinë e ekspertizës në fushat përkatëse dhe ndihmuar për të përmirësuar operacionet përgjatë gjithë zinxhirit të punës;

Edhe përgjatë vitit 2020 ASF, ka ruajtur fokusin e saj në rritje të pjesëmarrjes së femrave në të gjitha nivelet institucionale.

PUNONJËSE FEMRA

PUNONJËSE FEMRA
NË NIVEL
MENAXHUES



NUMRI I PUNONJËSVE
NË MBYLLJE TË VITIT 2020

Hapja e zyrave të reja

Viti pandemik, kushtëzoi dhe kufizoi aktivitetin normal të institucionit tonë, por jo planet tona të ekspansionit.

Më 1 Qershor 2020, ASF zgjeron aktivitetin e saj nëpërmjet hapjes së dy zyrave të reja. Në qytetin e

Lushnjës, **Agro & Social Fund** shtrin prezencën e saj për herë të parë, duke ngritur kështu Degën Lushnje dhe në qytetin e Tiranës rrit numrin e zyrave, duke hapur Nën Degën Tiranë.



Dega Rajonale Lushnje



Nën Dega Tiranë

Marketingu 2020

Pandemi na mësoi si të gjenerojmë forma teknologjike të marketingut. Përpos të gjithë vështirësive stafi i Agro & Social Fund duke patur në vëmendje respektimin e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 kombinoi zhvillimin e marketingut në terren, me atë online. Ndër të tjera, marketingu online shërbeu dhe si një mënyrë informimi për klientët mbi vendimet që komunikonte Banka e Shqipërisë, si dhe mbi ecurinë e kredive të marra nga ta në ASF.

Marketingu i zhvilluar nga të gjitha degët e ASF-së përpos vështirësive që mbarti ky vit, ka qenë efektiv dhe ajo që vlen të theksohet është gjithashtu modifikimi që pësoi marketimi nga ai *face to face* në një marketim online duke ngritur keshtu themelet e modalitetit modern të marketimit me hapa më të shpejt nga ç'mund të ishte parashikuar më parë nga ne.

Vlen të përmendim disa nga pjesmarrjet e ASF-së përgjatë vitit pandemik. Degët e Agro & Social Fund nuk munguan në aktivitetet, festat e përvitshme që zhvillohen në zona e krahina të ndryshem të Shqipërisë, të cilat sfiduan situatën e krijuar nga pandemia dhe duke qëndruar konform të gjitha rregullave/masave parandaluese zhvilluan aktivitetet e tyre, e stafi ynë nuk mungoi për të ofruar mbështetje nëpërmjet produkteve të kredisë të ideuara për të qenë sa me afër nevojave të klientëve. Disa nga pjesmarrjet e ASF-së gjatë 2020-ës në: **Festën e "Shën Kollit"** organizuar në fshatin e Sinicës; **Festën e "Shijonit"** organizuar në Kishën e Shën Gjon në Bradashesh; **Panairi "Puka Agro Fest"**, zhvilluar në qytetin e Pukës; **Panairi "Pro Grave Rurale"** zhvilluar në qytetin e Roskovecit; **Panairin "Tirana Agro 100"**, një organizim tre ditor i zhvilluar në Sheshin Skënderbej, Tiranë.

Në rrjetin social Facebook, Agro & Social Fund ka qenë aktive me postime, ku gjatë vitit 2020 ka patur një rritje me 2-fishim të numrit të ndjekësve. Me anë të këtyre postimeve është arritur të përcillet informacion, me një mesatare të arritur për postim tek 3,173 individë (profile). Gjithashtu dhe aktiviteti i ndjekësve në postimet e bëra në faqen e ASF-së, rezulton të ketë rritje të konsiderueshme, referuar këtu numrit të pëlqimeve dhe shpërndarjeve të arritura për postim.

Gjate këtij viti ASF ka qenë prezente edhe në rrjetin social Instagram, një prezence e shtuar për të qenë sa më afër klientëve tanë.



Bilanci

(Shumat në mijë Lek)

	2020	2019
Aktivët		
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	51,205	62,889
Hua dhe paradhënie për klientët	736,117	623,525
Aktivët afatgjata materiale	15,014	17,814
Aktive të tjera	10,710	11,149
Të drejtat mbi Asetet	45,769	53,363
Totali i aktiveve	858,814	768,740
Detyrimet dhe Kapitali i vet		
Detyrimet		
Huate (AC)	515,141	437,542
Detyrimet mbi Qeratë	46,661	53,782
Detyrime të tjera	16,126	17,188
	577,928	508,512
Kapitali i vet		
Kapitali aksionar	289,375	289,375
Humbje të mbartura	(29,147)	(50,929)
Fitimi i vitit	20,658	21,782
	280,886	260,228
Totali i detyrimeve dhe Kapitali i vet	858,814	768,740

Pasqyra e të ardhurave

(Shumat në mijë Lek)

	2020	2019
Interesa		
Të ardhura nga interesi	184,982	159,360
Shpenzime për interesa	(30,015)	(28,650)
Të ardhura neto nga interest	154,967	130,710
Të ardhura/(Shpenzime) të tjera	1,481	(1,315)
Shpenzime operative		
Zhvlërësimi	(17,204)	(9,088)
Shpenzime personeli	(77,104)	(67,640)
Humbje nga zhvlërësimi i huave	(20,050)	(10,456)
Shpenzime të tjera	(17,000)	(15,002)
Fitim/(humbje) neto nga kurset e këmbimit	(66)	(913)
Totali i shpenzimeve operative	(131,424)	(103,099)
Fitim/(humbja) përpara tatimit	25,024	26,296
Tatim fitimi	(4,366)	(4,514)
Fitim/(humbja) për vitin	20,658	21,782
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit	-	-
Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin	20,658	21,782

Pasqyra e flukseve të monetare

(Shumat në mijë Lek)

	2020	2019
Flukset monetare nga aktivitete operacionale		
Fitimi / (Humbja) për vitin	25,024	26,296
<i>Korrigjime për:</i>		
Zhvlerësimi	4,174	3,032
Zhvlerësimi në Të drejtat mbi Asetet	13,030	6,056
Pakësime neto në Aktivet Afatgjata	-	420
Humbje nga zhvlerësimi i huave	20,050	10,456
Të ardhura nga interesi	(184,982)	(159,360)
Shpenzime për interesa	30,015	28,650
<i>Ndryshime në:</i>		
Hua dhe paradhënie për klientët	(124,015)	(131,852)
Aktive të tjera	(8,893)	(5,175)
Detyrime të tjera	(1,064)	14,505
	(226,661)	(206,972)
Interesi i arkëtuar	176,355	151,717
Interesi i paguar	(36,950)	(28,166)
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	4,967	(4,853)

Pasqyra e flukseve të monetare

(Shumat në mijë Lek)

	2020	2019
Flukset monetare nga / (të perdorura) në aktivitete operacionale	(82,289)	(88,274)
(Shtesa)/ pakësime neto në aktivet afatgjata materiale	(1,374)	(8,933)
Flukset monetare përdorur në aktivitete investuese	(1,374)	(8,933)
Flukset monetare nga aktivitete financuese		
Fonde të (paguara)/ marra si hua dhe qira financiare	84,533	160,811
Pagesa në Detyrimet mbi Qeratë	(12,555)	(5,822)
Flukset monetare përdorur në aktivitete financuese	71,978	154,989
Rritja / (rënia) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente me to	(11,685)	57,782
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit	62,890	5,107
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit	51,205	62,889

Raporti i auditoreve të pavarur



Ernst & Young Certified Auditors
Albania Branch
NUIS: K619110121
Ibrahim Rugova Str, Sky Tower, 6th floor
1001, Tirana, Albania

Tel: +35542419575
ey.com

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Agro & Social Fund sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Agro & Social Fund sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Agro & Social Fund sh.p.k. paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontablistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2020 të Agro & Social Fund sh.p.k.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2020, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2020 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Raporti i auditoreve të pavarur

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë Informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Agro & Social Fund sh.p.k., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young
30 korrik 2021
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor






Performanca Sociale

Në mbështetje të Misionit dhe Vlerave të tij, Agro & Social Fund është i angazhuar të asistojë grupe të caktuara shoqërore që ballafaqohen me vështirësi ekonomike dhe të përjashtuar nga shërbimet financiare, të cilëve ju kufizohen mundësitë për të adresuar varfërinë, përmirësuar nivelin e jetesës, të ardhmen e fëmijëve dhe komuniteteve ku jetojnë.

Padyshim që viti 2020 pati vështirësi të shtuar në menaxhimin e mbarëvajtjes institucionale si pasojë e situatës pandemike shkaktuar nga Covid-19, që preku gjithë botën.

E megjithatë Agro & Social Fund, në fund të vitit 2020 mund të thotë me krenari se arriti t'i qëndronte pranë gjithë klientelës në nevojë, pasi ne ishim të vetëdijshëm që kriza e krijuar do të prekte më së pari shtresën më vulnerabel të popullsisë. Ne qëndruam të angazhuar, edhe në ditë të vështira kur institucionet e tjera po mbyllnin ose zvogëlonin aktivitetin, për t'ju shërbyer dhe për t'ju qëndruar pranë klientëve dhe bizneseve që kishin nevojë për financim. Së bashku me klientët tanë, ne punuam që të përballonim situatat që na prezantoi kjo sfidë për njerëzimin.

Impakti Social



Përmirësuar
jeta e 4,057
fëmijëve



Përmirësuar jeta e 4,057 fëmijëve

Me krenari Agro & Social Fund vazhdon të përkrah një ndër aspiratat më të ndjeshme të World Vision: "Rritjen e mirëqenies së qëndrueshme të fëmijëve brenda familjeve dhe komuniteteve, veçanërisht atyre më vulnerabel".

205
sipërmarrje
të reja



205 sipërmarrje të reja

Sipërmarrësit e rinj kanë potencialin për të ndërtuar një ekonomi të re gjeneruese dhe punë dinamike, ndaj do të jenë gjithmonë në fokus të Agro & Social Fund për t'u mbështetur në idetë e tyre.

Shërbyer
717
klienteve rural



Shërbyer 717 klienteve rural

Suportimi i klientëve në zona rurale për të rritur aktivitetin e tyre bujqësor/blegtoral është një mënyrë efektive për të luftuar varferinë. Përkrahja e tyre për të rritur fitimet nga shitja e prodhimeve është një mjet i qënësishëm në zhvillimin e këtyre zonave, të cilat lihen, relativisht, në harresë nga institucionet financiare.

Shërbyer
909 klienteve
femra



Shërbyer 909 klienteve femra

Ne besojmë se ndihma ndaj një gruaje reflekton më shpejt mirëqenien në familje. Në Shqipëri gratë kanë shumë pak mundësi ekonomike, siguri dhe liri. Ne mbështesim gratë për të zhvilluar aftësitë profesionale, për të filluar bizneset e tyre, si dhe për të investuar në mirëqenien e familjeve të tyre.

Shërbyer 230
klienteve
nga grupe
vulnerabël



Shërbyer 230 klienteve nga grupe vulnerabël

Komunitetet "Rom" dhe "Egjyptian" janë grupet më të nënshërbyera në Shqipëri, nisur nga kjo suportimi i tyre ka qenë gjithmonë në fokus të drejtëpërdrejtë të Agro & Social Fund. aktivitetin e tyre.

Shërbyer 517
klienteve
për edukim/
shëndetësi



Shërbyer 517 klienteve për edukim/shëndetësi

Kredia Sociale synon të sigurojë një mundësi për studentët që jetojnë në zonat rurale për të fituar qasje në shërbime arsimore, duke mbështetur ëndrrën e një studenti për tu arsimuar, dhe për të përmirësuar perspektivat e tyre të ardhshme të punësimit. Ndërkohë që ndihmon familjet të mund të paguajnë ilaçet, operacionet dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor që u duhen.

Projekte dhe Fushata

Agro & Social Fund është në kërkim të vazhdueshëm të projekteve që mund të ndihmojnë institucionin në arritjen e një performance efektive dhe eficientë; si edhe partnerëve që mund të zgjerojnë impaktin tonë dhe operimin konform rregullave ndërkombëtare.



është një organizatë ndërkombëtare jofitimprurëse, e themeluar në vitin 2005 me mision për të lidhur e afruar njerëzit nëpërmjet huadhënies dhe për të lehtësuar varfërinë. Kiva synon të ofrojë mundësi

për huamarrës në gjithë botën, veçanërisht vendet në zhvillim, përfshirë Shqipërinë. Edhe përgjatë vitit 2020 Agro & Social Fund pati një bashkëpunim shumë frytdhënës me Kiva-n, ku arritëm të rrisim me 50% fondet në dispozicion nga KIVA, nga shuma prej 800,000 USD në 1.2 milion USD.

ASF dhe Kiva gjatë 2020:

650 – kredi të financuara në Kiva të cilat ndihmojnë njerëzit të krijojnë mundësi për vete dhe komunitetin ku jetojnë

\$1,084,275 – financime në Kiva për të ndihmuar njerëzit të përmirësojnë jetën e tyre dhe të familjeve.

Fushata Borrow Wisely / Huamarrje e Zgjuar.

ASF për të dytin vit radhazi ju bashkua fushatës ndërkombëtare “Borrow Wisely”!

Këtë vit Agro & Social Fund kombinoi prezencën e saj në internet me aktivitetet fizike për të arritur tek Klientët tanë me qëllim edukimin për një huamarrje të zgjuar dhe të kujdesshme, duke ndjekur njëkohësisht të gjitha masat e sigurisë përkundrejt situatës pandemike.

ASF nisi fillimisht me trajnimin e stafit të degëve në mënyrë që ata të mundeshin të shpërndanin fushatën me të gjithë kontaktet e tyre. Njëkohësisht me fillimin e fushatës u prezantuan një hapsirë e dedikuar për fushatën në Website dhe Quiz-i (në shqip) për të kontrolluar stabilitetin financiar të familjes në çdo kohë.

Dorcias Aid International




Programi tre vjeçar “NËNITJA E SIPËRMARRJES NË RAJONIN E TROPOJËS NËPËRMJET KREDITIMIT” me partnerë DORCIAS ALBANIA, Agro & Social Fund dhe Shoqata “Integrim Tropoja” vijoi me zbatimin e tij përgjatë vitit 2020 në zonën e Tropojës. Lidhur me të gjitha fushat e ndërhyrjes në fokus mbetet promovimi i rolit ekonomik të grave, barazia gjinore, fuqizimi i grave dhe avokimi për shërbimin e duhur publik.

Diakonia Agapes



Ashtu si vitin e shkuar edhe gjatë vitit 2020 vazhdoi bashkëpunimi mes dy institucioneve me qëllim ngritjen e një sistemi funksional për aksesin ndaj shërbimeve të mikrokredisë për banorët e Njësie Administrative Gjinar, Shushicë dhe tregan të Bashkisë Elbasan.



Klientët Tanë



Florinte Marashi

Florinte është një ndër klientët e përsëritura të Agro & Social Fund. Ajo është një grua mjaft punëtore dhe ambicioze. Në jetën e saj ka bërë punë të ndryshme. Florintja punon në një fabrikë, merret me blegtori dhe gjithashtu ka hapur një bar-kafe të cilën e menaxhon vetë ajo. Falë katër financimeve të marra ne Agro & Social Fund ajo arriti të blinte një lopë fillimisht, produktet e të cilës i shet dhe gjithashtu arriti të hapë biznesin e saj, një bar-kafe, me një ambient shumë të këndshëm. Agro & Social Fund është shumë krenar që arrin të mbështesë femra punëtore si Florinte, të cilat me pak ndihmesë mund të arrijnë të bëjnë gjëra të mëdha në jetën e tyre.

Myfit Ustalli

Myfiti është një ndër klientët e financuar nga Agro & Social Fund për zgjerimin e aktivitetit agro që ai ushtron. Ai është një baba dhe bashkëshort i devotshëm dhe mjaft i përkushtuar ndaj aktivitetit të tij.

Myfiti ka një stallë me bagëti të imëta si dhe merret me mbjelljen e tokës që ai zotëron, me kultura të ndryshme bujqësore. Nëpërmjet financimit të marrë nga Agro & Social Fund, Myfiti arriti të zgjeronte stallën e tij dhe të blinte më

shumë të imëta, gjë që ndikoi drejtpërdrejtë në ekonominë e tij. Ai është mjaft i kënaqur me të ardhurat që nxjerr nga aktivitetet që kryen, pasi përveç familjes arrin të mbështesë ekonomikisht dhe prindërit e tij



Partnerët Tanë





NA NDIQNI NË RRJETET TONA SOCIALE

